

20.3.2022
Ora 17:06

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për disa ndryshime në vendimin nr. 11, datë 25.03.2021, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të komisionit të qendrës së votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit”, të ndryshuar”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

• Ilirjana	NANO	Kryetar
• Arens	ÇELA	Anëtar
• Dritan	ÇAKA	Anëtar
• Helga	VUKAJ	Anëtar
• Muharrem	ÇAKAJ	Anëtar
• Stafi	KQZ	Y. Merkaj, E. Meta
Parti	Politike:	S’ka prezent
Të	tjerë:	KRIIK

Znj. I. Nano: Mirëmbërëma, fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme ora 17.00. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë antarët e Komisionit Rregullator, Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe zyrtarë të tjerë të administratës, dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Në rendin e ditës për mbledhjen e sotme kemi shqyrtimin e dy projektvendimeve. I pari për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 1, datë 05 dhjetor 2020 “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoffimin e vendndodhjes së

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.03.2023*

qendrave të votimit, dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetqeverisjes vendore për zgjedhjet”. Projektvendimi i dytë për disa ndryshime në vendimin nr. 11, datë 25.03.2021, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të komisionit të qendrës së votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit”, të ndryshuar. Para se të fillojmë me shqyrtimin e dy projektakteve të cilat kanë ardhur si iniciativë e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve do t’u drejtohesha kolegëve nëse kanë diçka lidhur me rendin e dites apo dhe jashtë rendit të ditës. Po, zoti Çaka!

Z. D. Çaka: Faleminderit zonja kryetare! Atëhere ashtu siç shohim dhe nga rendi i ditës e sjellë nga ana e administratës, duke patur parasysh që është konsoliduar një praktikë e punës, jo vetëm të Komisionit Rregullator por edhe të komunikimeve me administratën, përpara thirrjes së mbledhjes dhe dërgimit zyrtar të akteve, nga ana e administratës është dërguar për njohje paraprake projektvendimi për disa ndryshime në vendimin nr. 11, datë 25.03.2021 të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të komisionit të qendrës së votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit”, të ndryshuar. Kjo është njëra nga arsyet të cilën, por duke parë dhe dokumentin e sjellë para dy ditësh nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm, pra njoftimin zyrtar, por kam parë që ka disa ndryshime në të dy variantet, të cilat të paktën mua personalisht, më kanë pamundësuar shqyrtimin më të detajuar të aktit dhe njëkohësisht besoj dhe të gjithë kupës sonë. Në këto kushte duke patur parasysh këto ndryshime por edhe për t’i dhënë vetes kohë për të dakortësuar për pika të aktit, do i kërkoja Komisionit Rregullator që këtë pikë të rendit të ditës ta hiqte nga shqyrtimi i ditës së sotme.

Znj. I. Nano: Në fakt ajo çka tha zoti Çaka është diçka që dhe unë personalisht e kam vërejtur, ndryshimet nga varjanti i dërguar për konsultim Komisionit

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.03.2023*

Rregullator deri te varjanti i dërguar zyrtarisht, dhe praktika jonë e punës së deritanishme është që antarët e Komisionit Rregullator veçmas apo së bashku, konsultojnë aktet e ardhura paraprakisht, për të arritur në një vendimmarrje sa më të mirë dhe në një vendimmarrje të bazuar në ligj. Unë kam vërejtur këto që tha zoti Çaka, por edhe disa problematika të tjera, të tipit ndryshon vetëm një gërmë e nenit në thelb dhe propozohet ndryshimi i përmbajtjes së gjithë nenit apo gjithë pikës, kështu që unë personalisht i bashkohem propozimit të zotit Çaka, do ftoja dhe kolegët e tjerë, nëse kanë për të shprehur diçka paraprakisht, ose në të kundërt të kalojmë në votimin e propozimit të zotit Çaka për heqjen nga rendi i ditës të këtij projektvendimi për ta kaluar në mbledhjen e rradhës. Atëhere kolegë, kush është dakord për heqjen nga rendi i ditës së këtij projektvendimi?

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z. Çela, z. Çaka, zgj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, projektvendimi për disa ndryshime në vendimin nr. 11, datë 25.03.2021 të Komisionit Rregullator, "Për mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të komisionit të qendrës së votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit", i ndryshuar, nuk shqyrtohet në këtë mbledhje, hiqet nga rendi i ditës dhe do të shqyrtohet në një mbledhje të afërt të Komisionit Rregullator.

***Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI***



20.3.2022
Ora 17:11

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr.1, datë 05 dhjetor 2020 “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit, dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetqeverisjes vendore për zgjedhjet”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-----------|--------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Y. Merkaj, E. Meta |
| Parti | Politike: | S’ka prezent |
| Të | tjerë: | KRIIK |

Znj. I. Nano: Atëhere fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit për disa udhëzime dhe shtesa në udhëzimin nr. 1, datë 05 dhjetor 2020 “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit, dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetqeverisjes vendore për zgjedhjet”. Është propozimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, do doja zoti Merkaj të prezantoni në mënyrë të përmbledhur ndryshimet e propozuar dhe argumentin lidhur mbi to.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.03.2023*

Z. Y. Merkaç: Faleminderit! Neni 20 i Kodit Zgjedhor parashikon kompetenca e Rregullatorit për të shqyrtuar dhe miratuar projektakte me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, gjithashtu kjo dispozitë parashikon se aktet administrative në bazë të Rregullatorit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, janë vendimet. Për këtë arsye kemi parashikuar dhe projektvendimin e mësipërm. Projektakti përmban disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 1, datë 05 dhjetor 2020. Ky udhëzim ka dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 108 pika 7, e Kodit Zgjedhor, që parashikon mënyrën e votimit të zgjedhësve që nuk mund të votojnë vet. Në fazën përgatitore për zhvillimin e zgjedhjeve të datës 14 Maj 2023, Komisioneri ka marrë të gjitha masat për të monitoruar zbatimin e detyrimeve të bashkive për evidentimin e qendrave të votimit ku janë të regjistruar persona me aftësi të kufizuar. Referuar komunikimit me bashkitë rezulton se në përafërsisht 2820 qendra votimi janë evidentuar votues me aftësi të kufizuar dhe nga këto, 190 qendra votimi janë në kate të dyta dhe 12 janë në kate të treta. Përafërsisht 1710 qendra votimi janë në kate të para, nga të cilat 572 qendra votimi nuk janë të pajisura me rampa ose me kalime të vazhdueshme horizontale. Pjesa tjetër e qendrave të votimit janë me akses të drejtpërdrejtë. Për 572 qendra votimi të cilat nuk janë të pajisura me rampa, bashkitë kanë informuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se do të vënë në dispozicion të votuesve me aftësi të kufizuar staf për asistimin e tyre. Në lidhje me qendrat e votimit të cilat janë të vendosura në katet e dyta dhe të treta, Komisioneri u ka kërkuar bashkive që t'i transferojnë ato në kate të para. Të gjitha bashkitë që kanë këtë problematikë duhet të marrin masat për të bërë transferimin e qendrave të votimit në katet e para dhe ky proces po ndiqet në dinamikë. Standartet teknike për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara janë të përcaktuar në vendimin nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave. Gjithashtu në projektaktet e propozuar është parashikuar dhe

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.03.2023*

mekanizmi i kontrollit për zbatimin e standarteve minimale të kërkuara, duke përcaktuar detyrimin e kryetarëve të bashkive, për të dhënë informacion Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për sa herë që i kërkohet. Ndryshimet në projektakt, adresojnë gjithashtu rekomandimet e OSBE ODIHR, rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit. Projektvendimi u është dërguar për mendim disa organizatave të shoqërisë civile të angazhuara me proceset zgjedhore dhe Fondacionit “Së bashku”, i cili ka përcjellë disa rekomandime. Së pari, ata kërkojnë që aksesueshmëria të jetë e pranishme në të gjitha qendrat e votimit pasi ajo mund t’u shërbejë jo vetëm personave me aftësi të kufizuara dhe personave me dëmtime të përkohshme por edhe të moshuarve apo personave që janë jashtë skemës së përfitimit të pagesës si pasojë e kësaj aftësie. Sqarojmë se pikërisht, duke pasur parasysh këto sa kërkohet, jemi kujdesur që të referohemi në standardet ligjore në fuqi të Republikës së Shqipërisë, që është vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1503, datë 19.11.2008. Së dyti, mënyra e vendosjes së mobiljeve që është kërkuar nga fondacioni “Së bashku” përfshirë dhomat e votimit, duhet të jenë të aksesueshme për gjithë personat me aftësi të kufizuara. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka pajisur në çdo palë zgjedhje qendrat e votimit me dhoma të fshehta votimi të posaçme për personat me aftësi të kufizuar. Përsa i përket rekomandimit të tretë, aksesueshmëria duhet të jetë e pranishme në të gjitha qendrat e votimit dhe mundësia për të votuar në mënyrë të pavarur për personat me aftësi të kufizuara në shikim. Për sa i përket këtij rekomandimi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pajis çdo qendër votimi me maskën për votuesit e verbër që është dhe alfabeti BRAILLE. Për sa më sipër po ju paraqesim projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës. Ju faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.03.2023*

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Merkaj, fillojmë me shqyrtimin në parim të projektvendimit. Personalisht më lejoni të them dy fjalë, në fakt është një çështje, që shqetësimin për të cilën e ka ngritur së pari Avokati i Popullit pak para zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin të vitit 2021, i është drejtuar Komisionit Rregullator me një rekomandim për të bërë rregullimet e nevojshme. Duke qënë që ishte shumë pak para zgjedhjeve, ishim gati në pamundësi për të miratuar një vendim i cili të ishte i zbatueshëm, nga njësitë e qeverisjes vendore. Në zgjedhjet e vitit të kaluar kuptohet ishin zgjedhje të pjesshme, kështu që është momenti tani që të vëmë në zbatim rekomandimin e Avokatit të Popullit, gjithashtu kjo problematikë është ngritur edhe nga ODIHR-i në raportin e vet për zgjedhjet, por dhe nga rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë si një nga detyrat që ngarkohen Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ajo çka doja të theksoja me këtë rast, sepse janë çështje me sensibilitet të shtuar edhe nga shoqatat të cilat mbrojnë të drejtat, dhe kujdesen për zbatimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, do doja të bëja një sqarim që sigurisht ne e dimë, jo në këto zgjedhje por në çdo zgjedhje ku vendosen qendrat e votimit, janë kryesisht shkolla dhe ambiente të tjera publike, kemi dhe disa ambiente private padyshim, por nuk është KQZ-ja që, le të themi, është përgjegjëse për zbatimin e standarteve të godinave në Shqipëri. Nga informacioni që na sollët dhe që relatoi Sekretari i Përgjithshëm, kjo çështje sensitive për KQZ-në, është bërë objekt i komunikimit të vazhdueshëm i KQZ-së me njësitë e vetqeverisjes vendore, dhe janë evidentuar të gjitha rastet me numër të përcaktuar qoftë të qendrave të votimit që i plotësojnë këto kushte, qoftë të qendrave të votimit që kanë nevojë për rregullime, por qoftë edhe të detyrimit në fakt që buron nga Kodi Zgjedhor por dhe që është marrë parasysh nga kryetarët e njësive të vetqeverisjes vendore, për t'i asistuar me persona ndihmës, personat me aftësi të kufizuara. Kolegë nëse kemi diçka në parim për projektvendimin? Kalojmë në votimin në parim të tij.

Kush është dakord?

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.03.2023*

Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet! Kalojmë në votimin nen për nen, apo pikë për pikë. Atëherë Komisioni Rregullator vendosi:

Në udhëzimin nr. 1, datë 01.12.2020, të Komisionit Rregullator, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Shkronja “b”, e pikës 3, e nenit 5 ndryshohet si më poshtë vijon: zbatimin e rregullave teknike sipas legjislacionit në fuqi për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar me qëllim aksesimin e tyre në qendrën e votimit duke siguruar së paku që:

i. Hyrja për në qendrën e votimit të ketë kalim të vazhdueshëm horizontal dhe me pjerrësi në pjesë të ndryshme

ii. Dyert e hyrjes për në çdo qendër votimi (hyrja kryesore dhe hyrja brenda QV-së) të lejojnë kalimin me lehtësi edhe nga personat në karrige me rrota. Pragu i derës përpara dhe pas saj të jetë në të njëjtin rrafsh me sipërfaqet e ambienteve.”.

b) Pas pikës 3, të nenit 5, shtohet pika 4, me këtë përmbajtje: “4. Në zbatim të shkronjës “b”, të pikës 3, të këtij neni, me kërkesë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, bashkitë dërgojnë informacionin për masat e marra, brenda 10 ditëve nga marrja e saj.”.

c) Në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 8, fjalët “...si rregull...” hiqen.

Kemi diçka për pikën 1 të këtij projektvendimi kolegë? Nëse jo kalojmë në votim.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundra: S'ka

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.03.2023*

Me 5 vota pro, miratohet pika 1!

Pika 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Miratohet, me 5 vota pro!

Po, kush është menduar të ngarkohet është të udhëzimi se ky është ndryshim në udhëzim, e kemi në udhëzimin 1 zbatimin nga ana e administratës, dakord!

Pika 3. Kundër këtij vendimi mund të behet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit, dhe një herë kolegë dakordësinë tuaj për projektvenimin në tërësi.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Miratohet, me 5 vota pro!

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.03.2023*

Sikundër thamë në fillim në diskutimet e fillimit, pika tjetër për t'u shqyrtuar sot do të shqyrtohet në një mbledhje të afërt të Rregullatorit, pas një konsultimi me Sekretarin e Përgjithshëm dhe zyrtarët që kanë përgatitur aktin. Duke qënë që nuk kemi një çështje tjetër për të diskutuar, mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Faleminderit!

Vendimi nr.11

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*

